



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 14, paragrafi 14.1 të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), dhe nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01.nr.110-392, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më datën 27.06.2023, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet subvencionimi i personave fizikë dhe juridikë, të cilët marrin në përkujdesje dhe mbajtje një (1) qen, apo më shumë.
2. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, shuma e subvencionimit për përkujdesjen dhe mbajtjen e qenit/ve, është në vlerë prej 50.00 € (pesëdhjetë euro) për secilin qen në muaj.
3. Komuna e Prishtinës i ndan 150,000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) euro nga kategoria e subvencioneve për pjesën e dytë të vitit 2023, të cilat do të shfrytëzohen për pagesat sipas pikës 2 të këtij vendimi.
4. Në rast të shkeljeve të kontratës për adaptimin, përkujdesjen dhe mbajtjen e qenit nga ana e personit fizik dhe juridik, gjoba e cila do të shqiptohet nga personi zyrtar, do të jetë nga 1000-3000 euro.
5. Kriteret për procedurat e adaptimit, përkujdesjes, mbajtjes dhe përcaktimi i kushteve të kontratës, ku përfshihet procedura e mbikëqyrjes dhe procedura e pagesave, përcaktohet me një akt të cilin e propozon Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë dhe miratohet nga Kryetari i Kryeqytetit.
6. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Kryeqytetit, Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë, Drejtoria e Financave dhe drejtoritë e tjera relevante.
7. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb - faqen e Komunës.

**KUVENDI I KRYEQYTETIT**  
**01-422/01-134273/23, më 29.06.2023**

**KRYESUES I MBLEDHJES SË KUVENDIT**  
**AJET BRAJSHORI**

